# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-458831**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kurti në SHBA: Strategji shtetërore për reagim ndaj verdiktit në Hagë - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/kurti-ne-shba-strategji-shteterore-per-reagim-ndaj-verdiktit-ne-hage/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 21:14:16 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 21:09:58 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `347f34ea7d44ab6c4861f538a7f77900a96b34c042045b0469fe03b00838794e` |
| TEKSTI | `39cbb8f1bd02d17bac6f21af0efb7f7404a2e4c86e8117a8bf3829746b729539` |
| PAMJA | `58860ebc40570f262cfc0e60212b953ee63f32afdbe52254f8efa72952a75b8b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `d7f03c4ace9df8b09fd04ff3a083965b131db2eb943610e5cef0bf5e1dee6166` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9c78c1c41a56a9cf37be606a5add6c7a1b056922b0a99f924a31d9b6f7124cd1` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d7f03c4ace9df8b09fd04ff3a083965b131db2eb943610e5cef0bf5e1dee6166`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVË | LAJM KRYESOR

# Kurti në SHBA: Strategji shtetërore për reagim ndaj verdiktit në Hagë

19 Shtator 2026 | 23:09

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Kryeministri Albin Kurti tha nga SHBA-ja, ku gjendet për vizitë, se Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar që të ofrojë mbështetje, në çdo mënyrë dhe me të gjitha mjetet që i ka në dispozicion, me qëllim korrigjimin e verdiktit të Dhomave të Specializuara ndaj ish krerëve të UÇK-së, i cili është i padrejtë juridikisht dhe moralisht dhe i pasaktë historikisht dhe faktikisht.

“Një dakordim mbi një strategji shtetërore për reagim sa më të përshtatshëm dhe efikas ndaj verdiktit të shkallës së parë, si në ndihmën e ekipeve në instancat e apelit, ashtu edhe në rrafshin diplomatik, është i nevojshëm.

Do të bashkëpunojmë me aleatët tanë ndërkombëtarë, do të angazhohemi pandërprerë në mbrojtjen e luftës sonë çlirimtare përballë propagandave të Serbisë dhe, njëkohësisht, në zbardhjen e masakrave dhe krimeve të tjera të Serbisë në Kosovë, të cilat Beogradi zyrtar, mbi 27 vjet pas përfundimit të luftës, po përpiqet akoma t’i fshehë”, shkroi në Facebook, Kurti.

Ai njoftoi se në ditën e parë të qëndrimit në New York, pati kënaqësinë të zhvillojë një bashkëbisedim frymëzues, “Between Here and Home”, me të rinjtë e diasporës shqiptare në Amerikë, organizuar nga tri grupe të të rinjve shqiptaro-amerikanë: ZANI, F’Oda, dhe Columbia University Albanian Society.

“Krahas kolegëve nga Qeveria e Republikës së Kosovës në delegacionin tonë janë edhe kryetarja e Preshevës Ardita Sinani dhe deputeti Shaip Kamberi.

Biseduam mbi një gamë të gjerë temash, përfshirë rritjen ekonomike prej 5.4% në tremujorin e parë të këtij viti, si dhe uljen e papunësisë nga 26% në 10% gjatë qeverisjes sonë. Sikurse edhe për nevojën për përmirësimin e mëtejshëm në integritetin dhe performancën e sistemit gjyqësor, i cili vazhdon të jetë cak i kritikave në raportet ndërkombetare, përfshirë atë të Komisionit Evropian.

Është e domosdoshme që të rinjtë të kontribuojnë në forcimin e barazisë gjinore dhe në promovimin e bashkëpunimit midis shqiptarëve në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe në mbarë botën”, shtoi Kurti.

**Shiko në:**

## LAJMI I FUNDIT

21:55 **Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, gjenerali Dedë Prenga: Ja pse Rama duhet të kërkojë falje**

21:40 **Eksperti: Ja si politikanët shqiptarë bënë një gabim fatal me ngritjen e Gjykatës Speciale**

21:21 **Dënimi i krerëve të UÇK-së, Çipa: Proces politik, vendimi të lexohet nga të gjithë faktorët shqiptarë**

21:05 **Vendimi i Hagës, Buzhala: Serbia do të nisë fushatë për tërheqjen e njohjeve të Kosovës**

20:49 **Buzhala: Gërvalla deklaronte se do të depozitonte fakte në Hagë, heshtja e saj pas vendimit është e pazakontë**

20:24 **Ylljet Aliçka “Qytetar Nderi” i Kolonjës, shkrimtari: Do të shkruaj për historitë e kësaj treve**

TESTIM

## LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË | LAJMI I FUNDIT | RAJONI | REVIEW

**Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, gjenerali Dedë Prenga: Ja pse Rama duhet të kërkojë falje**

I ftuar në "Review" me Greta Topjanën, gjenerali Dedë Prenga tha se edhe kryeministri Edi Rama duhet të kërkojë falje në lidhje me dënimin e...

21:55 | 19/09/2026

KOSOVË | LAJMI I FUNDIT | RAJONI | REVIEW

**Eksperti: Ja si politikanët shqiptarë bënë një gabim fatal me ngritjen e Gjykatës Speciale**

I ftuar në emisionin "Review" me Greta Topjanën, eksperti i çështjeve ndërkombëtare, Marlind Laçi, foli në lidhje me dënimin e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të...

21:40 | 19/09/2026

KOSOVË | LAJMI I FUNDIT | RAJONI | REVIEW

**Dënimi i krerëve të UÇK-së, Çipa: Proces politik, vendimi të lexohet nga të gjithë faktorët shqiptarë**

I ftuar në "Review" me Greta Topjanën, analisti Aleksandër Çipa foli në lidhje me vendimin e Hagës për dënimin e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të...

21:21 | 19/09/2026

**TEMA**

Vendi
Rajoni
Bota
Video

**SHËRBIME**

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

**KOMPANIA**

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontaktoni
Punësimi

**Follow Euronews on all platforms:**

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.